

# TRASHËGIMIA KULTURORE NË

# FO KU S.

TRASHËGIMIA KULTURORE NË SHQIPË

TRASHËGIMIA  
KULTURORE NË **FO  
KU  
S.**



BOTIMI I TEKSTEVE BURIMORE  
MBI PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE  
MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË  
KULTURORE NË GJUHËN SHQIPE

**Titulli:** “Trashëgimia Kulturore në Fokus: Botimi i teksteve burimore mbi praktikat e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore në gjuhën shqipe”

Botimi është mundësuar nga “Trashëgimia Kulturore pa Kufij Shqipëri” (Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania) me mbështetjen financiare të Suedisë nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim.

**Përkthimet nga origjinali:** Të ndryshëm referuar në çdo dokument përkatësisht

**Redaktoi:** Boiken Abazi

**Parathënie për botimin nga:** Elena Mamani, Lorenc Bejko dhe Boiken Abazi

**Koordinoi procesin e përkthimeve dhe publikimit:**

Elena Mamani, Regina Vathi, Pezana Rexha

**Foto:** © Bjori Thana, Regina Vathi

**Dizajni:** Ina (Hina) Shkëmbi, Joniz Osmanagaj

© CHwB Albania © ICOMOS Albania

Viti i botimit: 2023

196 f.: me foto ; 21 x 21 cm

**ISBN: 9789928801081**

1.Pasuria kulturore 2.Ruajtja dhe restaurimi 3.Menaxhimi 4.Shqipëri

904 :72 .03(496.5)

**Shtëpia Botuese:** “Graphic Line-01”



This work is distributed under the Creative Commons BY-NC-ND 4.0 licence, which enables re-users to copy and distribute the material in any medium or format in non-adapted form only, for non-commercial purposes only, and only so long as attribution is given to the creator.

Ky botim publikohet bazuar në licencën nga “Creative Commons BY-NC-ND 4.0”, e cila u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo mënyrë komunikimi ose format, por vetëm duke mos kryer përshtatje të formës, duke mos e përdorur për qëllime tregtare, si dhe për aq kohë sa i jepet krijuesit atributi përkatës.

# DEKLARATA E LIMËS MBI MENAXHIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË LIDHJE ME RISKUN NGA FATKEQËSITË

Simpoziumi Ndërkombëtar, 3 dhjetor 2010.

## ICOMOS

Përkthyer nga: Klodjana Gjata.  
Redaktuar nga: Boiken Abazi.

Versioni origjinal ©ICOMOS. Ky përkthim nuk është përkthim zyrtar ICOMOS-it. Ky përkthim në gjuhën shqipe botohet me lejen e ICOMOS-it, por nën përgjegjësinë e vetme të përkthyesit/botuesit.

## PARATHËNIE

Profesionistë të trashëgimisë kulturore, arkitektë, arkeologë, inxhinierë ndërtimi dhe specialistë të tjerë nga Peruja dhe Japonia, u takuan gjatë “Simpoziumit mbi Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore në lidhje me Riskun nga Fatkeqësitë, Konservimi i Qëndrueshëm i Trashëgimisë Kulturore Urbane në Zonat Sizmike. Simpoziumi kishte për qëllim ndarjen e përvojave për rimëkëmbjen pas fatkeqësive si dhe diskutimin mbi rolin e inxhinierëve të ndërtimit dhe arkitektëve konservues” për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore që ndodhet në zona tërmetesh.

1. Bota është e ndarë në zona sizmike dhe josizmike. Tërmetet ndodhin kryesisht përgjatë dy brezave të mëdhenj sizmikë: brezat sizmikë të Paqësorit, ku shkarkohet më shumë se 95% e energjisë sizmike, dhe brezat euroaziatikë. Në vijim të Kartave Ndërkombëtare të Konservimit dhe politikave të konservimit, tashmë adresohet dëmi i akumuluar ndaj trashëgimisë kulturore lidhur me zonat që kanë një rrezikshmëri të lartë për tërmete të forta.
2. Një numër i konsiderueshëm i pasurive të Trashëgimisë Kulturore Botërore ndodhet në këto zona sizmike, veçanërisht në brezat e pllakës së Paqësorit në Azi dhe Amerikë Latine, në Karaibe, në Evropën Jugore, në Azinë Perëndimore dhe Qendrore. Në këto rajone parashikohen dëme të mundshme për shkak të tërmeteve të forta. Për këtë arsye, këto rajone duhet të ndërmarrin masa emergjente për të mbrojtur jetën e njerëzve dhe trashëgiminë kulturore nga fatkeqësitë.
3. Autoritetet vendore shpesh i shembnin strukturat historike pas një tërmeti të fortë. Brezi i ri i profesionistëve duhet ta ndryshojë këtë prirje përmes një përjasjeje shumëdisiplinore që synon mbrojtjen e qëndrueshme të trashëgimisë. Gjithë çmbetet nga trashëgimia kulturore duhet të konservohet ose restaurohet, duke marrë parasysh parimet e integritetit dhe autenticitetit, të kuptuara sipas kontekstit lokal.
4. Komitetet Kombëtare të ICOMOS-it inkurajohen të kontribuojnë në pasurimin e frymës së Kartave të Konservimit, për të marrë në konsideratë zbutjen e dëmeve ndaj trashëgimisë kulturore në zonat sizmike.

5. Konservimi i trashëgimisë mund të realizohet nëpërmjet arsimit, duke organizuar kurse të përditësuar, seminare dhe aktivitete trajnuese. Institucionet akademike do të mund të luanin një rol të rëndësishëm duke përfshirë zhvillimin e qëndrueshëm të siteve të trashëgimisë në studimet e trashëgimisë kulturore dhe turizmit.
6. Komunikimi ndërmjet anëtarëve të komunitetit dhe profesionistëve me formime të ndryshme disiplinore, akademike dhe institucionale është i nevojshëm për të shpjeguar dhe përhapur njohuritë mbi arsyet pse restaurimi i trashëgimisë duhet të bëhet duke respektuar autenticitetin dhe integritetin e saj. Me synimin për ta përhapur këtë shpjegim, një vëmendje e nevojshme duhet t'i kushtohet nga ana e gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias.
7. Duhet theksuar përgjegjësia e autoriteteve për gatishmërinë ndaj tërmetit të fortë të radhës. Edhe pse jeta njerëzve është e paçmueshme, shumë ndërtesa të trashëgimisë në rrezik shembjeje përdoren gjithashtu për strehim, për biznese dhe/ose shërbime të tjera turistike.
8. Zbutja e pasojave dhe gatishmëria ndaj fatkeqësive kërkon një vlerësim gjithëpërfshirës të rreziqeve ndaj sitit, si dhe banorëve dhe vizitorëve të tij. Duhet të hartohen gjithashtu plane të hollësishme shpëtimi dhe reagimi ndaj emergjencave. Për realizimin e këtij qëllimi, identifikimi i kapacitetit pritës të ndërtesave dhe hapësirave publike historike për parandalimin e bllokimit të qarkullimit gjatë fatkeqësive është një detyrim. Duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur inspektimit paraprak, për të miratuar vetëm zhvillimin e atyre aktiviteteve që nuk paraqesin rrezik për jetën e banorëve ose vizitorëve të siteve.

## HISTORIKU DHE DEKLARATAT

1. Konventa e Trashëgimisë Botërore ka theksuar përgjegjësinë e secilit Shtet Palë për të hartuar politikat kombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
2. Në përgjigje të fatkeqësive, prioriteti i parë është shpëtimi i jetës së njerëzve dhe sigurimi i nevojave themelore për viktimat. Më pas, masat urgjente dhe rimëkëmbja duhet të shmangin dëmtimin e mëtejshëm të trashëgimisë kulturore.
3. Analiza ndërdisiplinore dhe vlerësimi strukturor

i ndërtesave të trashëgimisë duhet të përfshijë përdorimin e materialeve dhe teknologjive tradicionale, nëse ato janë të përshtatshme. Duhet t'i kushtohet vëmendje njohjes së thellë të ndërtesave historike dhe sjelljes së tyre dinamike nëpërmjet modelimit analitik ose fizik, testeve jo-shkatërruese dhe mjeteve të tjera moderne të dokumentimit. Duhet të merret parasysh kriteri i bazuar mbi efektshmërinë, duke e plotësuar me kriterin e bazuar mbi fuqinë.

4. Historiku i tërmeteve, veçanërisht aktiviteti sizmik brenda dhe rreth vendndodhjeve të trashëgimisë, dhe ndikimi i tërmeteve të fundit në strukturat tradicionale dhe jotradicionale, duhet të dokumentohet dhe të vihet në dispozicion.
5. Për të arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit të riskut, duhet të merren parasysh synimet e mëposhtme strategjike të rekomanduara nga Takimi Tematik i "UN-WCDR" në Kobe, mbi Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore në lidhje me Riskun, i mbajtur në vitin 2005. Duhet integruar trashëgimia kulturore në politikat dhe mekanizmat ekzistues për reduktimin e fatkeqësive në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor, duke përfshirë organizata dhe ekspertizë të kualifikuar të trashëgimisë. Nevojitet përfshirja e komunitetit vendas në përgatitjen dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të riskut dhe në të gjitha fazat e rimëkëmbjes pas një fatkeqësie. Nevojitet përfshirja e trashëgimisë kulturore si një subjekt për zhvillimin e kërkimeve shkencore dhe studimeve teknike, si dhe në programe arsimore dhe trajnimi që lidhen me menaxhimin e riskut dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, për të zhvilluar metoda operative që do ta bënin shtetin të aftë për të përballuar rreziqet që kërcënojnë trashëgiminë kulturore.

## **REKOMANDIME MBI VEPRIMET**

### **Rekomandime të përgjithshme:**

1. Duhet ndërmarrë nisma për rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjen e vendimmarrësve dhe komuniteteve vendase në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të trashëgimisë kulturore për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë.
2. Duhet nxitur krijimi i rrjeteve kombëtare dhe ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore dhe

fatkeqësive, për përkrahjen e integritit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në fushën më të gjerë të menaxhimit të fatkeqësive.

### **Për organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe joqeveritare:**

3. Organizata ndërkombëtare ndërqeveritare dhe joqeveritare që merren me trashëgiminë kulturore, si: UNESCO-ja, ICCROM-i, ICOMOS-i, ICOM-i, IFLA dhe ICA, si dhe Komiteti Ndërkombëtar i Mburojës Blu ("International Committee of Blue Shiled" – "ICBS") dhe instrumentet përkatëse ndërkombëtare, si Konventa e Trashëgimisë Botërore, duhet të veprojnë për reduktimin e riskut, duke e përmirësuar dhe përkrahur këtë praktikë përmes politikave, programeve dhe veprimtarisë së tyre.
4. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar shteteve të cilat ndodhen në zona sizmike, me qëllim garantimin e sigurisë në qytetet me trashëgimi kulturore "të gjallë" (ekzistuese), duke marrë parasysh edhe realitetin e tyre ekologjik. Tërmetet e përsëritura shkaktojnë akumulim dëmsh në zonat dhe sitet historiko-urbane. Duhet inkurajuar zhvillimi i teknologjisë dhe novacionit me synim konsolidimin e nevojshëm strukturor që përputhet me teknikat dhe materialet e strukturës origjinale, dhe që është i kthyeshëm.
5. Inkurajohet përfshirja e menaxhimit të trashëgimisë kulturore në lidhje me riskun nga fatkeqësitë në kuadër të programeve të asistencës së agjencive të ndryshme ndërkombëtare të zhvillimit dhe bashkëpunimit, të cilat duhet ta përkrahin këtë politikë edhe brenda institucioneve të tjera shumëpalëshe të zhvillimit, ku aderojnë këto agjenci.

### **Për qeveritë qendrore, rajonale dhe vendore:**

6. Qeveritë duhet të krijojnë komitete ekspertësh që do të mundësonin shkëmbimin e opinioneve për formulimin e politikave të koordinuara përmes afrimit, me njëri-tjetrin, të specialistëve ndërdisiplinorë, si inxhinierët e ndërtimit, arkitektët, arkeologët dhe specialistët të tjerë të trashëgimisë kulturore. Qeveritë duhet gjithashtu të përkrahin masat e nevojshme administrative dhe financiare për zhvillimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse që zbusin pasojat nga fatkeqësitë në pasuritë e trashëgimisë kulturore, si dhe në mjedisin urban që i rrethon.

7. Qeveritë duhet të forcojnë mbështetjen institucionale dhe qeverisjen për gatishmërinë ndaj fatkeqësive nëpërmjet rregulloreve të nevojshme, të hartuara në konsultim me shoqërinë civile. Institucionet publike, pronarët dhe palët e tjera të interesit duhet të inkurajohen të punojnë së bashku në hartimin e politikave për ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore.
  8. Institucionet përgjegjëse për Trashëgiminë Kulturore dhe për zbutjen e pasojave nga fatkeqësitë, duhet të zhvillojnë së bashku masa të veçanta për monitorimin, për inspektimin periodik të qëndrueshmërisë statike të ndërtesave të trashëgimisë, për zbutjen e dëmeve nga tërmetet, për të ruajtur vlerat e trashëgimisë dhe për të përdorur teknologji të përshtatshme për ruajtjen e vazhdimësisë në kohë të këtyre vlerave.
  9. Duhet inkurajuar rikuperimi i trashëgimisë shpirtërore nëpërmjet asistencës kombëtare dhe ndërkombëtare, përmes kuptimit gjithëpërfshirës të shoqërisë për programet e rehabilitimit, ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve edukative për banorët, në mënyrë që të përmirësohet siguria e tyre dhe kushtet e jetës së përditshme.
  10. Në kontekstin e Konventës së Trashëgimisë Botërore dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare, duhet të miratohen dhe zbatohen politika, procedura dhe masa ligjore gjithëpërfshirëse për të integruar trashëgiminë kulturore në të gjitha programet e reduktimit të fatkeqësive dhe për të përfshirë planet e menaxhimit të riskut në sistemin e menaxhimit të pasurive të trashëgimisë.
  11. Ekspertiza e trashëgimisë kulturore qeveritare dhe joqeveritare duhet bërë pjesë e organeve kombëtare ekzistuese dhe të ardhshme, që janë të mandatuara për të mbikëqyrur zhvillimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe planeve të veprimit për reduktimin e fatkeqësive.
  12. Të bashkëpunohet me administratën vendore për të siguruar burime të përshtatshme për miratimin dhe zbatimin e strategjive të qëndrueshme të menaxhimit të pasurive të trashëgimisë kulturore në lidhje me riskun në territorin e tyre, në veçanti në zonat historiko-urbane dhe peizazhet kulturore "të gjalla" (ekzistuese), si dhe për mjedisin e tyre rrethues, duke përfshirë identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e riskut nga fatkeqësitë.
  13. Të inkurajohet dhe mbështetet shoqëria civile dhe nismat joqeveritare në fushën e reduktimit të riskut për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet masave që synojnë zvogëlimin e faktorëve themelorë të cenueshmërisë.
  14. Të nisen dhe mbështeten fushata për edukimin dhe ndërgjegjësimin, për ta shpërndarë gjerësisht informacionin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore para, gjatë dhe pas fatkeqësive. Të përdoren njohuritë, novacioni dhe edukimi për të ndërtuar një kulturë të parandalimit të fatkeqësive.
  15. Qeveritë qendrore, rajonale dhe vendore inkurajohen të përkrahin bashkërendimin e politikave për menaxhimin e riskut nga tërmetet në zonat me trashëgimi kulturore, planifikimin urban dhe menaxhimin e fatkeqësive në lidhje me pasuritë e trashëgimisë kulturore dhe mjedisin e tyre rrethues.
- Për institucionet arsimore/kërkimore:**
16. Të zhvillojnë programe të përbashkëta trajnimi për riparimin dhe konsolidimin, për kualifikimin e profesionistëve dhe personelit të emergjencave civile, dhe për të realizuar një integrim që nuk vret syrin.
  17. Edukimi është pikënisja e të kuptuarit të rëndësisë së gatishmërisë ndaj fatkeqësive. Prandaj, brezi i ri duhet të ndërgjegjësohet mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, si dhe mbi përgjegjësinë që ka për konservimin e saj.
  18. Institucionet akademike si universitetet, shkollat teknike dhe qendrat kërkimore inkurajohen të përkrahin edukimin dhe punën kërkimore mbi menaxhimin gjithëpërfshirës në lidhje me fatkeqësitë në zonat me trashëgimi kulturore që kanë aktivitet të lartë sizmik, dhe inkurajohen të angazhohen veçanërisht në aktivitete ndërkombëtare, si krijimi i rrjeteve për të përmirësuar cilësinë e veprimtarisë së tyre duke bashkëpunuar me qendrat rajonale të trashëgimisë kulturore.

“Deklarata e Limës mbi Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore në lidhje me Riskun nga Fatkeqësitë” u hartua dhe u propozua nga profesionistët e poshtëshënuar, dhe u miratua me duartrokite dhe miratimin e përbashkët të të gjithë pjesëmarrësve të Simpoziumit Ndërkombëtar mbi “Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore në lidhje me Riskun nga Fatkeqësitë, Konservimi i Qëndrueshëm i Trashëgimisë Kulturore Urbane në Zonat Sizmike. Përvoja e Rimëkëmbjes pas fatkeqësisë: Roli i inxhinierëve të ndërtimit dhe arkitektëve konservues”, organizuar nga Universiteti Kombëtar i Inxhinierisë CIS-MID (UNI), Universiteti Ritsumeikan (RITS-DMUCH), me mbështetjen e ICOMOS-ICORP-it, ICOMOS-Peru. Simpoziumi u mbajt në sallën Jinnai, Qendra Kulturore Japoni-Peru, më 3 dhjetor 2010.

#### (Në rend alfabetik)

Patricia GIBU  
Univesiteti Kombëtar i Inxhinierisë, FIC-CISMID, anëtar hartues

Kanefusa MASUDA  
Universiteti Ritsumeikan, Japoni, ICOMOS-ICORP, anëtar hartues

O. Keiko MENDOZA SHIMADA  
Universiteti Ritsumeikan, Japoni, ICOMOS-ICORP, anëtar hartues

Mariana MOULD DE PEASE  
Koleksioni Franklin Pease G.Y, ICOMOS-Peru, anëtar hartues

Victor PIMENTEL  
Univesiteti Kombëtar i Inxhinierisë, ICOMOS Peru, anëtar hartues

Julio VARGAS NEUMANN  
Universiteti Katolik Papnor i Perusë, ICOMOS Peru, anëtar hartues

Carlos ZAVALA  
Univesiteti Kombëtar i Inxhinierisë, FIC-CISMID, anëtar hartues

Blanca ALVA GUERRERO  
Ministria e Kulturës, Drejtor i Mbrojtjes së Trashëgimisë

Mario BEGAZO BEGAZO  
Spitali Goyeneche, Arequipa, Drejtor

Antonio BLANCO BLASCO  
Universiteti Katolik Papnor i Perusë, Profesor

Beatriz BOZA MORILLO  
Ministria e Kulturës, Zyra rajonale Arequipa, arkitekt konservues

María del Carmen CORRALES  
Ministria e Kulturës, arkitekt konservues

Juan DE ORELLANA  
Universiteti “Sacred Heart”, Limë, arkitekt konservues

Jorge LARREA TOVAR  
Shkolla e Formimit Profesional, Limë, Drejtor

Fernando LÓPEZ SÁNCHEZ  
Muzeu i Artit në Katedralen e Limës, Drejtor

Jenny PARRA SMALL  
Projekti i qyteteve të qëndrueshme - PNUD, Peru, Instituti i Mbrojtjes Civile, arkitekt

Ricardo PROAÑO  
Univesiteti Kombëtar i Inxhinierisë, asistent profesor

Hugo SCALETTI  
Univesiteti Kombëtar i Inxhinierisë, asistent profesor

Ruth SHADY  
President i ICOMOS-Peru

Teresa VILCAPOMA  
Universiteti “Sacred Heart”, Limë, arkitekt konservues